



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

vNumri i lëndës: 2021:192038
Datë: 08.04.2024
Numri i dokumentit: 05559569

C.nr. 2157/21

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSËM, Divizioni Civil, gjyqtari Vegim Maloku, në çështjen juridike-kontestimore të paditëses S.F. nga P. të cilën e përfaqëson Sahare Muçaj Nevzati avokate me seli në Prizren Rr/ Ibrahim Lutfiu nr.10, kundër të paditurit J.I. nga P. Rr. E... nr..., baza juridike: *Pasurimi i pa bazë*, vlera e kontestit 650 euro, jashtë seance me datë 08.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M
-në bazë të pohimit-

- I. I. APROVOHET kërkesëpadia e paditëses S.F. nga P., NË TËRËSI SI E BAZUAR.
- II. DETYROHET i padituri J.I. nga P. Rr. E... nr..., që paditëses S.F. nga P. në emër të pasurimit të pa bazë për biletën e aeroplanit të datës 24.12.2020 me numër të rezervimit 719559 t'ia paguajë shumën e të hollave në lartësi prej 650 euro dhe atë me kamatë ligjore prej 8% të llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë (27.08.2021) e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi e nën kërcenim të përmbarimit të detyrueshëm.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja, në këtë gjykatë ka ushtruar padi me datë 27.08.2021, kundër të paditurit, baza juridike: *Pasurim i pa bazë*, vlera e kontestit 650 euro.

Paditësja në padi ka theksuar se ka rezervuar biletën e udhëtimit në Agjencionin E. për në M.-P. ë me datë 24.12.2020- fatura e rezervimit I padituri me datë 22.12.2020 ka pranuar shumën e të hollave prej 650 euro, në emër të pagesës së biletave në W.. Kur ka mbërritur në aeroport ka kuptuar se nuk mund të udhëtojnë, ngase biletat fare nuk janë rezervuar, andaj i padituri pa bazë ligjore është pasuruar në shumën prej 650 euro.

I padituri, me parashtrësën e datës 13.02.2024, ka dhënë përgjigje në padi, në të cilën ka deklaruar se: nuk e konteston kërkesëpadinë e palës paditëse dhe të njëjtën e pohon, kurse gjykatës i ka propozuar që të marrë aktgjykim konform nenit 148 të LPK-së. Nuk ka kontestuar faktin se në llogarinë e tij bankare është deponuar shuma e të hollave prej 650 euro.

Gjykata ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar duke qenë se në mes palëve ndërgjyqëse nuk ishin kontestuese faktet vendimtare të çështjes dhe se i padituri ka pranuar kërkesëpadinë.

Gjykata nga shqyrtimi i gjithmbarshëm i çështjes nuk ka gjetur ndonjë rrethanë, për të cilën duhet kujdesur kryesisht e cila do të pengonte aprovimin e kërkesëpadiisë dhe rrethana tjera që t'i vënte në kundërshtim faktet dhe provat e çështjes me pohimin e kërkesëpadiisë.

Gjykata pas analizimit të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, thënieve në padi dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga i padituri, ka gjetur se janë në harmoni me njëra tjetrën dhe me pohimin e palës së paditur, pasi që në shkresat e lëndës ka dëshmi se pala paditëse ka rezervuar biletën dhe ka deponuar të hollat prej 650 euro në llogarinë e palës së paditur. Nga këto prova gjykata provoi faktin se palët ndërgjyqëse kishin krijuar raporte juridike në mes vete, e nga të cilat rrjedh se palët kanë të drejtë të disponojnë me kërkesat e tyre përderisa janë dhe pjesëmarrës në raporte juridike, dhe se nuk ka pengesa në kuptim të nenit 3 par.3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, si dhe duke u bazuar ne nenin 3.2 të LPK-së, në të cilin precizohet fakti se *“palët mund të heqin dorë nga kërkesat e tyre, ta njohin kërkesën e palës kundërshtare si dhe të bëjnë ujdi gjyqësore lidhur me kontestin e tyre”*.

Gjykata pas pohimit të kërkesëpadiisë nga ana e të paditurës, konstatoi se kërkesa është e disponueshme për palët, prandaj në kuptim të nenit 148 paragrafi 1 të Ligjit të procedurës Kontestimore (LPK) – me të cilin përcaktohet se *“ në qoftë se i padituri deri në përfundim të shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep, pa*

shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesën (aktgjykimi në bazë të pohimit)''- vendosi pa shqyrtim të mëtejshëm si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Andaj bazuar në të cekurat si me larte edhe është vendosur si ne dispozitiv.

Bazuar në nenin 382 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve parashihet se “ *debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën e që lartësia e kamatë vonesës është 8% në vit, për veç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë*”.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata e mori bazuar në nenin 463.1 të LPK- së, pasi që pala paditëse nuk i ka specifikuar shpenzimet e procedurës, ndonëse të njëjtat i ka kërkuar.

Mbi bazën e parashtrimeve të mësipërme është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 143 dhe 148.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2021:192038, C.nr.2157/21 Dt.08.04.2024

G j y q t a r i:
Vegim Maloku

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët mund të ushtrojnë ankese në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate. Në kuptim të nenit 181 par.2 të LPK-së, ankesa mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore apo nga shkak se deklarata e pohimit është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit.